

Compensating Blessings

By Bishop Gérald Caussé
Presiding Bishop

Bekimet Kompensuese

Nga Peshkopi Zherald Kosé,
Peshkopi Kryesues

April 2025 general conference

While many circumstances in life may be beyond our control, none of us is beyond the reach of the Lord's infinite blessings.

Serving in the Presiding Bishopric, I have had the privilege of meeting Latter-day Saints around the world in a variety of places and cultures. I have been continually inspired by your abiding faith and devotion to the Lord Jesus Christ. Yet I have also been moved by the diverse and often difficult circumstances many of you face—challenges such as illness, disability, limited resources, fewer opportunities for marriage or education, abuse by others, and other limitations or constraints. At times, these trials may seem to hinder your progress and challenge your genuine efforts to live the gospel fully, making it more difficult to serve, worship, and fulfill sacred duties.

My dear friends, if you ever feel limited or disadvantaged by the circumstances of your life, I want you to know this: The Lord loves you personally. He knows your circumstances, and the door to His blessings remains wide open to you no matter the challenges you face.

I have learned this truth through a personal experience that, though seemingly insignificant, left a lasting impression on me. At the age of 22, while serving in the French Air Force in Paris, I was thrilled to learn that Elder Neal A. Maxwell, an Apostle of the Lord, would be speaking at a conference on the Champs-Élysées. However, just before the event, I received orders to drive a senior officer to the airport at the exact time the conference was set to take place.

Ndërsa shumë rrethana në jetë mund të jenë përtej kontrollit tonë, asnjëri prej nesh nuk është përtej shtrirjes së bekimeve të pafundme të Zotit.

Prej shërbimit në Peshkopatën Kryesuese, kam pasur privilegjin të takoj shenjtorë të ditëve të mëvonshme në mbarë botën nga vende dhe kultura të larmishme. Jam frymëzuar vazhdimisht nga besimi dhe përkushtimi juaj i qëndrueshëm te Zoti Jezu Krisht. Megjithatë, jam prekur edhe nga rrethanat e ndryshme dhe shpesh të vështira me të cilat përballen shumë prej jush – sfida të tilla si sëmundje, paaftësi, burime të kufizuara, mundësi më të pakta për martesë ose arsimim, keqtrajtim nga të tjerët dhe pengesa apo kufizime të tjera. Ndonjëherë, këto sprova mund të duken se e pengojnë përparimin tuaj dhe i sfidojnë përpjekjet tuaja të çiltra për ta jetuar ungjillin plotësisht, duke jua bërë më të vështirë shërbimin, adhurimin dhe përmbushjen e detyrave të shenjta.

Miq të mi të dashur, nëse ndonjëherë ndiheni të kufizuar ose pafavorizuar nga rrethanat e jetës, dua që të dini këtë: Zoti ju do personalisht. Ai i di rrethanat tuaja dhe dera për te bekimet e Tij mbetet tërësisht e hapur për ju pavarësisht nga sfidat me të cilat përballeni.

E kam mësuar këtë të vërtetë nëpërmjet një përvoja vetjake që, ndonëse në dukje e parëndësishme, më la një mbresë afatgjatë. Në moshën 22-vjeçare, ndërsa shërbeja në Forcat Ajrore Franceze në Paris, u emocionova kur mora vesh se Plaku Nil A. Maksuell, një Apostull i Zotit, do të fliste në një konferencë në Shons-Elizé. Megjithatë, pak para ngjarjes, mora urdhër për të çuar në aeroport me makinë një oficer të lartë pikërisht në orën kur ishte caktuar të zhvillohej

I was disappointed. But determined to attend, I dropped the officer off and rushed to the conference. After finding a parking spot, I sprinted down the Champs-Élysées to the meeting place and arrived breathless with only five minutes left before the meeting ended. Just as I entered, I heard Elder Maxwell say, “I will now give you an apostolic blessing.” In that instant, I had a beautiful, unforgettable spiritual experience. I was overcome by the Spirit, and the words of the blessing seemed to penetrate every fiber of my soul as though they were meant just for me.

What I experienced that day was a small yet powerful manifestation of a comforting aspect of God’s plan for His children: When circumstances beyond our control prevent us from fulfilling the righteous desires of our hearts, the Lord will compensate in ways that allow us to receive His promised blessings.

This reassuring truth is grounded in three key principles found in the restored gospel of Jesus Christ:

God loves each of us perfectly. “He inviteth [us] all to come unto him and partake of his goodness.” His plan of redemption ensures that everyone, without exception, will be granted a just opportunity to one day receive the blessings of salvation and exaltation.

Because God is both just and merciful and His plan is perfect, He will not hold us accountable for things beyond our control. Elder Neal A. Maxwell explained that “God ... takes into merciful account not only our desires and our performance, but also the degrees of difficulty which our varied circumstances impose upon us.”

Through Jesus Christ and His Atonement, we can find the strength to endure and ultimately overcome all of life’s challenges. As Alma taught, the Savior took upon Himself not only the sins of the repentant but also “the pains and the sicknesses of his people” and “their infirmities.” Thus, beyond redeeming us from our mistakes, the Lord’s mercy and grace sustain us through injustices, deficiencies, and limitations imposed by our mortal experience.

Receiving these compensating blessings comes with certain conditions. The Lord asks us to do “all we can” and to “offer [our] whole souls as an offering unto him.” This requires a deep desire, a sincere and faithful heart, and our utmost

konferenca.

Isha i zhgënjyer. Por, i vendosur për të marrë pjesë, e lashë oficerin në aeroport dhe nxitova për në konferencë. Pasi gjeta një vend parkimi, vrapova teposhtë Shons-Elizésë për në vendin e mbledhjes dhe mbërrita duke m’u mbajtur fryma vetëm pesë minuta para se mbledhja të përfundonte. Sapo hyra, dëgjova Plakun Maksuell të thoshte: “Tani do t’ju jap një bekim apostolik”. Në atë çast, pata një përvojë shpirtërore të bukur e të paharrueshme. U pushtova nga Shpirti dhe fjalët e bekimit dukej se përshkuan çdo qelizë të qenies sime, sikur të ishin menduar vetëm për mua.

Ajo që përjetova atë ditë ishte një shfaqje e vogël por e fuqishme e një aspekti ngushëllues të planit të Perëndisë për fëmijët e Tij: Kur rrethanat përtej kontrollit tonë na pengojnë që t’i përbushim dëshirat e drejta të zemrës, Zoti do të na kompensojë në mënyra që na lejojnë t’i marrim bekimet e Tij të premtuara.

Kjo e vërtetë sigurose e ka bazën tek tri parime kyç që gjenden tek ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit:

Perëndia e do secilin prej nesh përsosur-isht. “Ai [na] fton të gjithë[ve] të vij[m]ë tek ai dhe të marri[m] pjesë në mirësinë e tij.” Plani i Tij i shëlbimit siguron që të gjithëve, pa përjashtim, t’u jepet një mundësi e paanshme për të marrë një ditë bekimet e shpëtimit dhe ekzaltimit.

Për shkak se Perëndia është i drejtë edhe i mëshirshëm dhe plani i Tij është i përsosur, Ai nuk do të na quajë përgjegjës për gjëra përtej kontrollit tonë. Plaku Nil A. Maksuell shpjegoi se “Perëndia ... merr parasysh plot mëshirë jo vetëm dëshirat tona dhe arritjet tona, por edhe shkallët e vështirësisë që na imponojnë rrethanat tona të ndryshme”.

Nëpërmjet Jezu Krishtit dhe Shlyerjes së Tij, ne mund të gjejmë forcën për t’i duruar dhe përfundimisht kapërcyer të gjitha sfidat e jetës. Siç dha mësim Alma, Shpëtimtari mori mbi Vete jo vetëm mëkatet e të penduarve, por edhe “dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij” dhe “dobësitë e tyre”. Si rrjedhim, përtej shëlbimit nga gabimet tona, mëshira dhe hiri i Zotit na mbështetin përgjatë padrejtësive, mangësive dhe kufizimeve të imponuara nga përvoja jonë në vdekshmëri.

Marrja e këtyre bekimeve kompensuese vjen me kushte të caktuara. Zoti na kërkon të bëjmë “gjithçka që ne mund[emi]” dhe të “dhuro[jmë] tërë shpirtat [tanë] si një dhuratë ndaj tij”. Kjo kërkon një dëshirë të thellë, një zemër të sinqertë

diligence in keeping His commandments and aligning our will with His.

When our earnest efforts fall short of our aspirations due to circumstances beyond our control, the Lord still accepts the desires of our hearts as a worthy offering. President Dallin H. Oaks taught, “We will be blessed for the righteous desires of our hearts even though some outside circumstance has made it impossible for us to carry those desires into action.”

As the Prophet Joseph Smith worried about his brother Alvin, who had died without receiving essential gospel ordinances, he received this comforting revelation: “All that shall die henceforth without a knowledge of [the gospel], who would have received it with all their hearts, shall be heirs of [the celestial kingdom of God].” The Lord then added, “For I, the Lord, will judge all men according to their works, according to the desire of their hearts.”

What matters to the Lord is not merely whether we are able but whether we are willing to do all we can to follow Him as our Savior.

A friend once comforted a young missionary grieving over his early release due to health reasons, despite his sincere prayers and earnest desire to serve. This friend shared a scripture in which the Lord declared that when His children “go with all their might” and “cease not their diligence” to fulfill His commandments, “and their enemies [which may include adverse circumstances in our lives] hinder them from performing that work, behold, it behooveth me to require that work no more at the hands of those [people], but to accept of their offerings.”

My friend testified to this young man that God knew he had given his very best in answering the call to serve. He assured him that the Lord had accepted his offering and that the blessings promised to all faithful missionaries would not be withheld.

The Lord’s compensating blessings often come through the kindness and service of others who help us accomplish what we cannot do on our own. I remember a time when, living far from one of our daughters in France, we felt helpless to assist her after a difficult delivery.

e besnike dhe zellin tonë maksimal për zbatimin e urdhërimeve të Tij dhe përputhjen e vullnetit tonë me të Tijin.

Kur përpjekjet tona më ngulmuese nuk i përmbushin aspiratat tona për shkak të rrethanave përtej kontrollit tonë, Zoti prapëseprapë mund t’i pranojë dëshirat e zemrës sonë si një ofertë e denjë. Presidenti Dallin H. Oaks dha mësim: “Ne do të bekohemi për dëshirat e drejta të zemrës sonë edhe pse disa rrethana të jashtme e kanë bërë të pamundur që t’i vëmë në veprim ato dëshira”.

Ndërsa Profeti Jozef Smith shqetësohej për vëllanë e tij, Alvinin, i cili kishte vdekur pa marrë ordinancat thelbësore të ungjillit, ai mori këtë zbulesë ngushëlluese: “Ata që do të vdesin që tani e tutje pa dituri për [ungjillin], të cilët do ta kishin pranuar atë me gjithë zemër, do të jenë trashëgimtarë të [mbretërisë çelestiale të Perëndisë]”. Më pas Zoti shtoi: “Sepse unë, Zoti, do t’i gjykoj të gjithë njerëzit sipas punëve të tyre, sipas dëshirës së zemrave të tyre”.

Ajo që ka rëndësi për Zotin nuk është thjesht a jemitë aftë, por a jemitë gatshëm të bëjmë gjithçka që mundemi për ta ndjekur Atë si Shpëtimtarin tonë.

Një herë një mik ngushëloi një misionar të ri në moshë që u pikëllua për lirimin e parakohshëm nga thirrja për arsye shëndetësore, pavarësisht nga lutjet e tij të çiltra dhe dëshira e sinqertë për të shërbyer. Ky mik tregoi një shkrim të shenjtë ku Zoti shpalli se kur fëmijët e Tij “punojnë me gjithë fuqinë e tyre” dhe “nuk e pushojnë zellin e tyre” për të përmbushur urdhërimet e Tij, “dhe armiqtë e tyre [që mund të përfshijnë rrethanat e pafavorshme në jetën tonë] ... i pengojnë nga kryerja e asaj pune, vini re, mua nuk më duhet më ta kërkoj atë punë nga duart e atyre [njerëzve], por t’i pranoj ofertat e tyre”.

Miku im i dëshmoi të riut se Perëndia e dinte se ai kishte dhënë më të mirën e vet për t’iu përgjigjur thirrjes për të shërbyer. Ai e siguroi atë se Zoti e kishte pranuar ofertën e tij dhe se bekimet e premtuara për të gjithë misionarët besnikë nuk do të mbaheshin.

Bekimet kompensuese të Zotit shpesh vijnë nëpërmjet dashamirësisë dhe shërbimit të tjerëve që na ndihmojnë të arrijmë atë që nuk mund ta bëjmë vetë. Më kujtohet një rast kur, ngaqë jetonim larg njëres prej vajzave tona në Francë, u ndiem të pafuqishëm për ta ndihmuar

That same week our ward in Utah sought help for a mother who had just given birth to twins. My wife, Valérie, volunteered to bring a meal for her, with a prayer in her heart for both this new mother and our daughter in need. Soon after, we learned that the sisters in our daughter's ward in France had organized to provide meals for her family. To us, God had answered our prayers, sending His angels to bring comfort when we couldn't.

When facing limitations and challenges, may we recognize our own blessings—our gifts, resources, and time—and use them to serve those in need. In doing so, we will not only bless others but invite healing and compensation into our own lives.

One of the most powerful ways we may contribute to God's compensating blessings is through the vicarious work we do for our ancestors in the house of the Lord. As we perform ordinances on their behalf, we actively participate in the Lord's great work of salvation, using our gifts and abilities to provide blessings to those who did not have the opportunity to receive them during their mortal lives.

The loving service we offer in holy temples reminds us that the Savior's grace extends beyond this life. In the life to come, we may be given new opportunities to accomplish what we could not do in this mortal life. Speaking to sisters who had not yet found an eternal companion, President Lorenzo Snow lovingly said: "There is no Latter-day Saint who dies after having lived a faithful life who will lose anything because of having failed to do certain things when opportunities were not furnished him or her. ... They will have all the blessings, exaltation and glory that any man or woman will have who had this opportunity."

This message of hope and comfort is for all of us, children of God. None of us can escape the challenges and limitations of mortality. After all, we are all born with an inherent incapacity to save ourselves. Yet we have a loving Savior, and "we know that it is by [His] grace that we are saved, after all we can do."

I testify that while many circumstances in life

atë pas një lindjeje të vështirë. Po atë javë, lagjia jonë në Jutë kërkoi ndihmë për një nënë që sapo kishte sjellë në jetë binjakë. Bashkëshortja ime, Valeria, doli vullnetare për t'i çuar asaj një vakt ushqimi, me një lutje në zemër për këtë nënë të re dhe vajzën tonë në nevojë. Pak kohë pas kësaj, morëm vesh se motrat në lagjen e vajzës sonë në Francë ishin organizuar për të siguruar vakte ushqimi për familjen e saj. Sipas nesh, Perëndia u ishte përgjigjur lutjeve tona, duke dërguar engjëjt e Tij për të çuar ngushëllim atëherë kur ne nuk mundeshim.

Kur përballemi me kufizime dhe sfida, i dallofshim vetë bekimet tona, dhuratat, burimet dhe kohën tonë dhe i përdorshim ato për t'u shërbyer njerëzve në nevojë! Duke e bërë këtë, ne jo vetëm që do t'i bekojmë të tjerët, por do të ftojme shërim dhe kompensim në vetë jetën tonë.

Një nga mënyrat më të fuqishme se si mund të kontribuojmë në bekimet kompensuese të Perëndisë, është përmes punës si mëkëmbës që bëjmë për paraardhësit tanë në shtëpinë e Zotit. Ndërsa kryejmë ordinancat në emër të tyre, marrim pjesë në mënyrë aktive në veprën e madhërisme të Zotit për shpëtimin, duke i përdorur dhuratat dhe aftësitë tona për t'u ofruar bekime atyre që nuk patën mundësinë t'i merrnin ato gjatë jetës së tyre në vdekshmëri.

Shërbimi i përzemërt që ofrojmë në tempujt e shenjtë na kujton se hiri i Shpëtimtarit shtrihet përtej kësaj jete. Në jetën që do të vijë, mund të na jepen mundësi të reja për të arritur atë që nuk mund ta bënim në këtë jetë në vdekshmëri. Duke u folur motrave që nuk kishin gjetur ende një shok të përjetshëm, Presidenti Lorenzo Snow tha me dashuri: "Asnjë shenjtor i ditëve të mëvonshme që vdes pasi ka jetuar një jetë besnike, nuk do të humbasë asgjë ngaqë nuk mundi të bëjë disa gjëra ndërkohë që atij apo asaj nuk iu dhanë mundësitë. ... Ai apo ajo do të ketë të gjitha bekimet, ekzaltimin dhe lavdinë që mund të ketë një burrë apo grua që e pati këtë mundësi."

Ky mesazh shprehe dhe ngushëllimi është për të gjithë ne, fëmijët e Perëndisë. Asnjëri nga ne nuk mund t'u shpëtojë sfidave dhe kufizimeve të vdekshmërisë. Në fund të fundit, të gjithë vijmë në jetë me një paaftësi të lindur për të shpëtuar veten. Megjithatë, kemi një Shpëtimtar të dashur, dhe "ne e dimë se ne shpëtohem nëpërmjet hirit [të Tij], pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë".

Unë dëshmoj se ndërsa shumë rrethana në

may be beyond our control, none of us is beyond the reach of the Lord's infinite blessings. Through His atoning sacrifice, the Savior will compensate for every inability and injustice if we offer our whole souls to Him. In the name of Jesus Christ, amen.

jetë mund të jenë përtej kontrollit tonë, asnjëri prej nesh nuk është përtej shtrirjes së bekimeve të pafundme të Zotit. Nëpërmjet flijimit të Tij shlyes, Shpëtimtari do të na kompensojë për çdo paaftësi dhe padrejtësi nëse i dhurojmë Atij tërë shpirtrat tanë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen.